



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTIRREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 122, Datë 17.07.2020

“MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SH.A. PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS  
ADMINISTRATIVE PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE NR. 73/2020, MBI  
MIRATIMIN E “KONTRATË TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE  
NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE AKSIONET E SË  
CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE  
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL/FSHU PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE  
FUNDORË”.**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 55 dhe 66 të Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” si dhe neneve 15 dhe 16 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.86/5 prot datë 13.07.2020 e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarreveshjeve, lidhur me kërkesën e shoqërisë FSHU sha , për pezullimin e procedurës administrative për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 73/2020, mbi miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU për furnizimin e klientëve fundorë”,

**Konstatohet se:**

- Në datë 22.04.2020, Bordi i ERE me vendimin nr. 73, u shpreh në lidhje me miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të shërbimit universal /FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë”.
- Në datë 07.05.2020, shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 3882 Prot, ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE nr. 73/2020.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 93, datë 08.06.2020, vendosi; *Zgjatjen me 30 ditë të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. për rishikimin e vendimit të ERE Nr. 73/2020, mbi miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë, si të pa mbështetur*

*në prova të reja të tilla që mund të çojnë Bordin e Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në rishikimin e tij.*

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 675/5 prot, datë 18.06.2020, iu drejtua shoqërisë FSHU sh.a. me kërkesën për informacion më të zgjeruar në lidhje me shkaqet ligjore që e çuan në një kërkesë të tillë për rishikimin e dispozitave të kontratës së miratuar si dhe kërkesën për një analizë të argumentuar në lidhje me impaktin financiar që sipas FSHU sh.a. mund të shkaktojnë dispozitat e kontratës e cila është miratuar nga ERE pas një procesi të gjatë konsultimi me palët në kontratë si dhe palët e interesit.
- Në vijim të kërkesës së ERE si më sipër, si dhe brenda afatit të parashikuar në vendimmarrjen e ERE nr. 93, datë 08.06.2020, për shtyrjen e afatit të trajtimit të kërkesës për rishikim të vendimit të ERE, nr. 73, të datës 22.04.2020, shoqëria FSHU Sha me shkresën e saj protokolluar në ERE me nr. 675/6, datë 06.07.2020, i'u drejtua ERE-s me spjegime në lidhje me sa kërkuar si dhe kërkesën për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së ERE në lidhje me kërkesën për rishikim të vendimit të bordit të ERE nr. 73/2020.
- FSHU sh.a. argumenton se: FSHU sh.a. ka kërkuar rishikim të pjesshëm të vendimit të bordit të ERE nr. 73/2020, e më konkretisht ndryshime në nenin 9 pika 3 të kontratës së miratuar me vendimin e sipërcituar, duke sqaruar se *parashikimi i kësaj dispozite rrit kostot e sigurimit të energjisë elektrike me bazë ditore/orare në treg të parregulluar. Blerja e emergjencës me bazë orare/ditore, rrit riskun e sigurimit të kësaj energjie si dhe çmimin e blerjes.*
- FSHU sh.a., në shkresën e saj të datës 06.07.2020, mes të tjerave bën me dije se është në proces negociimi me shoqërinë KESH sh.a., palë në këtë kontratë për të dakortësuar ndryshime në dispozitat e Kontratës TIP të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 73/2020 .
- Në nenin 55 & 66 të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, parashikohet se: *Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet dhe shqyrtohet nga organi publik kompetent. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.*
- Në analizë të sa më sipër, duke vlerësuar se hapat proceduralë të ndjekur nga FSHU Sha për të adresuar në ERE jo vetëm kërkesën për rishikim por edhe atë për pezullim e zënie të afatit për trajtimin e kërkesës pas plotësimit të kushtit (mbylljes së negociatave me KESH Sha ) janë të ligjshëm e në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Vlerësojmë se kjo kërkesë duhet vlerësuar, e palëve në këtë kontratë u duhet dhënë koha e nevojshme për diskutim e negociim mbi ndryshimet e propozuara në dispozitën për të cilën është kërkuar rishikimi i vendimit të ERE nr. 73/2020.
- Në kuptim të parashikimeve të Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, nenit 16 pika 3, është e rëndësishme të ritheksojmë se: *Kërkesa për rishikim vendimi nuk pezullon zbatimin e vendimit me përjashtim kur bordi vendos ndryshe.*
- *Vendimi i bordit të ERE nr. 73, datë 22.04.2020, Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës*

kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal për furnizimin e klientëve fundorë, mbetet në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. për pezullimin e procedurës administrative për rishikimin e vendimit të ERE Nr.73/2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU Sha për furnizimin e klientëve fundorë”, deri në përfundimin e negociatave mes palëve në kontratë, për ndryshimet në nenin 9 të kësaj kontrate.
2. Shoqëria FSHU sh.a., të informojë ERE-n mbi ecurinë e negociatave për qëllime të rishikimit të vendimit të bordit të ERE Nr.73/2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU Sha për furnizimin e klientëve fundorë”,
3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**